



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP A.nr.10/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR], me vendbanim në SHBA, të parashtruar ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. Protokolli 01/3698/2025 datë 08.12.2025, për refuzimin e kundërshtimit administrativ në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.12.2025, mori këtë :

V E N D I M

HEDHET ankesa ZP.Anr.10/2025 datë 10.12.2025, e parashtruar nga [REDAKTUAR] me vendbanim në SHBA parashtruar kundër Vendimit të KQZ-së, me nr. Protokolli 01/3698/2025 datë 08.12.2025, për shkak të mos regjistrimit si votues jashtë Kosove për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025, **në mungesë të interesit juridik.**

A r s y e t i m

Me datë 10.12.2025, PZAP-i, përmes email-it zyrtar ka pranuar një ankesë nga [REDAKTUAR] me vendbanim në SHBA, në të cilën pretendohet se e njëjta me datën 5 dhjetor ne ora 3:45pm ka aplikuar ne KQZ per regjistrim si votues jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare. Parashtruesja e ankesës thekson se me datën 5 dhjetor ne ora 5:48 pm KQZ e ka refuzuar aplikimin e saj me arsyetimin se i mungon fotografia me dokumentin identifikues ne dorë. E njëjta thekson se menjëherë pas marrjes së njoftimit nga KQZ ka parashtruar kundërshtim administrativ ne KQZ duke i bashkangjitur fotografinë e saj me dokumente identifikuese ne dorë. Parashtruesja e ankesës thekson se pavarësisht dorëzimit të këtyre dëshmive të plota me datën 08.12.2025 në ora 3:25 pm ka pranuar email, KQZ për kundërshtimin administrativ nuk e ka pranuar aplikimin e saj duke i pamundësuar të drejtën e votës. E njëjta thekson se këto veprime janë ne kundërshtim dhe ka kërkuar nga PZAP-i që të ta

obligoj KQZ-në qeta përfshijë në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe ti mundësohet e drejta për të votuar. Parashtruesja në ankese ka bashkangjitur dëshmitë si fotografinë e saj me dokumente identifikuese ne dorë, kopje e letërnjoftimit, dhe vendimit të KQZ-së, me nr. Protokolli 01/3698/2025 datë 08.12.2025, për refuzimin e kundërshtimit administrativ.

Në përgjigje në kërkesë të KQZ-së, KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Pas verifikimit nga shërbimi votues i KQZ-së, është dëshmuar se pala ankuese gabimisht është futur ne listën e të refuzuarve. Kundërshtimi i pranuar nga votuesja është aprovuar dhe e njëjta është e regjistruar për votim jashtë Kosovës. Si dëshmi kanë bashkangjitur dëftesën e regjistrimit për votim jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht ankesën dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

- Parashtrueses së ankesës i mungon interesi juridik.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 5 dhjetor ne ora 5:48 pm KQZ e ka refuzuar aplikimin e parashtrueses së ankesës me arsyetimin se i mungon fotografia me dokumentin identifikues ne dorë. E njëjta menjëherë pas marrjes së njoftimit nga KQZ ka parashtruar kundërshtim administrativ ne KQZ dhe të njëjtës i është refuzuar kërkesa për regjistrim duke ia pamundësuar të drejtën e votës

Me rastin e shqyrtimit të ankesës PZAP iu ka drejtuar KQZ-së për të dhënë përgjigje lidhur me arsyet e refuzimit të palës ankuese për tu regjistruar si votuese jashtë Kosovës. KQZ me anë të përgjigjes në ankese ka konfirmuar se pas verifikimit nga shërbimi votues i KQZ-së, është dëshmuar se pala ankuese gabimisht është futur ne listën e të refuzuarve, andaj kundërshtimi i pranuar nga votuesja është aprovuar dhe e njëjta është e regjistruar për votim jashtë Kosovës, ku si dëshmi kanë bashkangjitur dëftesën e regjistrimit për votim jashtë Kosovës me emrin e parashtrueses së ankesës.

Paneli duke vlerësuar ankesën në fjalë vlerëson se në rastin konkret palës ankuese i mungon interesi juridik për parashtrimin e ankesës, pasi që e njëjta është e regjistruar nga KQZ-ja, për votim dhe e njëjtat gjendet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë bazë dhe nga arsyet e sipërhënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 13 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 01/2025 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.A nr. 10/2025 më datën 13.12.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.